



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:015666

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05726641

C.nr.660/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Liridona Haziri Mustafa, me bashkëpunëtorin profesional Milot Mehmeti, në çështjen kontestimore të paditëses A. Sh. nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fadil Sinanaj, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Telekom i Kosovës SH.A, Prishtinë, për shkak të kompensimit të shpërblimit jubilar, shpenzimeve të ushqimit dhe differences në pagë, vlera e kontestit 5,408.48 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 14.05.2024, mori këtë:

AKTVENDIM

KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditësit A. Sh. nga Gjilani, kundër të paditurës Telekom i Kosovës SH.A, Prishtinë, për shkak të kompensimit të shpërblimit jubilar, shpenzimeve të ushqimit dhe differences në pagë, vlera e kontestit 5,408.48 euro.

Arsyetim

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij më 09.01.2024, ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin e shpërblimit jubilar, shpenzimeve të ushqimit dhe differences në pagë, vlera e kontestit 5,408.48 euro.

Me parashtrësën e datës 04.03.2024, paditësi e ka tërhequr padinë ndaj të paditurës.

Gjykata, bazuar në nenin 261.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore që përcakton se “Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditues vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga se u tha më lartë dhe në bazë të nenit 3 e lidhur me nenin 261 parag. 3 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2024:015666
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05726641

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.660/2024, më datë 14.05.2024

Gjyqtarja,
Liridona Haziri Mustafa

UDHËZIM JURIDIK: Ndaj këtij aktvendimit nuk është e lejuar ankesa.